STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 9 nëntor 2012

GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) NJOFTON FONDIN E NDIHMES TE EMPIRE STATE PER TE ASISTUAR ME NDIHMEN PER STREHIMIN PAS URAGANIT SENDI (SANDY)

Fondet do të synohen për rindërtimin dhe rinovimin e shtëpive të dëmtuara për të siguruar se banorët e Nju Jorkut mund të kthehen në komunitetet e tyre

Banorë të shquar të Nju Jorkut bashkohen për të krijuar PSA për të mbledhur fonde

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) njoftoi sot krijimin e Fondit të Ndihmës të Empire State, të përkushtuar ndaj ndihmës së banorëve të panumërt të Nju Jorkut shtëpitë e të cilëve janë dëmtuar ose shkatërruar pas Uraganit Sendi (Sandy).

Fondet e dhuruara do të shpërndahen në rajonet e goditura më rëndë anembanë rajonit, të drejtuara veçanërisht për kostot që kanë lidhje me sigurimin e strehimit afat-gjatë dhe rindërtimin e shtëpive. Megjithëse disa prej pronarëve të shtëpive do të marrin ndihmë nga sigurimi privat, FEMA dhe burime të tjera financimi, në shumë raste banorët e Nju Jorkut do të përballen me një diferencë të konsiderueshme ndërmjet kostos së riparimit ose zëvendësimit të shtëpive të tyre dhe ndihmës së disponueshme. Fondi i Ndihmës i Empire State do të përqëndrohet në plotësimin e diferencës së financimit për të siguruar se banorë të panumërt të Nju Jorkut të mund të vazhdojnë t'a quajnë Empire State shtëpinë e tyre.

"Kam kaluar një pjesë të madhe të karrierës time të përqëndruar në gjetjen e zgjidhjeve të strehimit për familjet në kohë të krizave," tha Guvernatori Kuomo (Cuomo). "E kam parë vetë krizën me të cilën përballen pikërisht tani bashkëqytetarët e mi të Nju Jorkut dhe ata kanë nevojë për ndihmë me rindërtimin. Fondi i Ndihmës i Empire State do të përkushtohet ndaj ndihmës së tyre për të rindërtuar shtëpitë e tyre anembanë rajoneve të prekura të shtetit për periudhën afat-gjatë, duke plotësuar diferencën ndërmjet asaj që mund të bëjë qeveria dhe sigurimi privat dhe asaj për të cilën kanë nevojë banorët e Nju Jorkut përfundimisht për të rindërtuar jetën e tyre. Kjo do të lejojë që shtetasit të kontribuojnë, korporatat partnere të vazhdojnë ndihmën e tyre bujare dhe ekspertët në fushën e strehimit dhe të infrastrukturës të ndihmojnë në përpjekjet tona. Bujaria e bashkë-qytetarëve tanë do të luajë një rol të madh në ndihmën për banorët tanë që të vazhdojnë t'a quajnë Nju Jorkun shtëpinë e tyre për shumë vite të ardhshme."

Fondi do të mbikqyret nga një bord prej pesë personash, i kryesuar nga Xhim Simons. Bordi përfshin:

Xhemjs H. Simons (Kryetari i Bordit), President i Euclidean Capital, një zyrë familjare dhe

Albanian

Kryetari i Bordit i Renaissance Technologies LLC.

Uilliam C. Rudin (President), CEO i Rudin Management Company dhe Kryetar i Shoqatës për një Nju Jork më të Mirë (ABNY)

Xhejn Rosenthal (Sekretare), Producente e filmit dhe televizionit, bashkë-themeluese dhe CEO e Tribeca Enterprises dhe Festivalit të Filmit të Tribecas, bashkë-themeluese dhe bashkë-kryetare e Institutit jo për fitim të Filmit Tribeca

Ricard J. Sirota (Mbajtës i Thesarit), Ish-Kryetar i Autoritetit të Qytetit të Bateri Park dhe Kryetar i Fondacionit Walter N. Danrich.

Ronald E. Bleilok, Partner administrator në GenNx360 Capital Partners, një firmë e kapitalit privat

Xhim Simons tha, "Kur ndodh katastrofa, banorët e Nju Jorkut gjithnjë kanë bërë ç'munden për të ndihmuar ata që janë në nevojë dhe për të rindërtuar. Ndërsa fonde të tjera janë duke synuar sigurimin e furnizimeve të emergjencës dhe ndihmë të menjëhershme, Fondi i Ndihmës i Empire State synon veçanërisht rindërtimin dhe rinovimin e shtëpive në zonat e goditura më rëndë anembanë shtetit në periudhën afat-gjatë. Megjithëse Uragani Sendi (Sandy) shkatërroi dhe çrrënjosi jetën e një numri të panumërt njerëzish, me ndihmën e njerëzve, bizneseve dhe dhuruesve të tjerë bujarë mund të sigurojmë se banorët e shtetit tona janë në gjendje të vazhdojnë t'a quajnë Nju Jorkun shtëpinë e tyre."

Si pjesë e krijimit të fondit, banorë të shquar të Nju Jorkut janë duke u bashkuar dhe duke dhuruar kohën e tyre për të krijuar një njoftim të shërbimit publik që do të transmetohet në vend dhe anembanë rajonit për të ndihmuar në mbledhjen e parave për fondin. Pjesëmarrësit e konfirmuar përfshijnë: Methju Broderik, Ed Bërns, Keti Kurik, Robert De Niro, Edi Falko, Xhenifer Konelli, Majkëll J. Foks, Upi Goldberg, Ken Hauërd, Dejvid Hajd Pirs, Nejthën Lein, Met Loër, Xhuliana Margulies, Xhon Mekenro, Endrju Mekarthi, Dru Nieporent, Al Paçino, Brajën Stoks Mitçëll dhe Amar'e Stoudemajër. Rrjete të televizionit dhe kabllit që përfshijnë ABC, CBS, FOX dhe NBC Universal, si dhe sistemet e kabllit Cablevision dhe Time Warner Cable, kanë rënë dakort që të transmetojnë PSA pa asnjë kosto. Google gjithashtu ka rënë dakort që të ndihmojë më promovimin e PSA-së në internet. PSA është duke u prodhuar falas nga rregjizori Deni Klinc në bashkëpunim me Deutsch Inc. dhe Tribeca Enterprises.

Fondi i Ndihmës i Empire State këshillon që individët ose organizatat që kërkojnë të dhurojnë për fondin duhet të vizitojnë www.empirestaterelief.com. Për të bërë një dhurim prej $10 për Fondin, dërgoni me tekst "RELIEF" (735433) në 80000.

Fondi i Ndihmës i Empire State do të përkushtojë 100% të dhurimeve për programet dhe nuk mban një pagesë administrative për shpenzimet e funksionimit. Fondi është në procesin e bërjes së kërkesës për miratim si një bamirësi publike 501(c)(3), në mënyrë që të gjitha dhurimet të jenë të zbritshme nga taksat në nivelin e lejuar nga ligji. Për më shumë informacion, ju lutemi vizitoni www.empirestaterelief.com.

Përkushtime janë bërë nga: AT&T, Xhejms Simons, Fondacioni ABNY, Fondacioni Uilliam dhe Ofelia Rudin, Cablevision, Time Warner Cable, United Health Group, Fondacioni i Familjes Blavatnik, Access Industries, Empire Blue Cross Blue Shield, PepsiCo, Iconix Brand Group, Signature Bank, Parsons Corporation, Rite Aid Corporation, Fondacioni Coca Cola, Fondacioni Friars Club, Google dhe të tjerë.

Fondi këshillon për individët që bëjnë dhurime prej $10.00 në Fondin e Ndihmës të Empire State nëpërmjet mesazheve me tekst: Tarifa do të shfaqen në faturën tuaj të shërbimit me valë ose do të zbrihen nga shuma juaj e paguar paraprakisht. Të gjitha blerjet duhet të autorizohen nga mbajtësi i llogarisë. Duhet të jetë mbi moshën 18 vjeç ose të ketë lejen e prindërve për të mare pjesë. Tarifa të mesazheve dhe të të dhënave mund të zbatohen. Dërgoni me tekst STOP në 80000 për TE NDALUAR. Dërgoni me tekst HELP në 80000 për NDIHME. Kushtet e plota: mGive.org/T. Praktika e konfidencialitetit: mGive.org/P

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418